



Pranuar / Doretuar Prilijeno/Protidato Received/Delivery	02.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2248/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.735/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2577/2021, të datës 27.01.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.735/2021, të datës 16.08.2021 e parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Gjergj Balsha", nr.89, Dragodan- Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.735/2021 e datës 16.08.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës së datës 26.12.2005 me numër të referencës 07/1-01A/1028, në pozitën "Zyrtare e lartë për infrastrukturë rrugore" në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, me datën 30.07.2021, ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës lidhur me kompensimin për pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor si dhe shtesën në pagë për 0.5% të pagës për çdo vit dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Drejtoria e personelit të Policisë së Kosovës me datën 02.08.2021, ka

njoftuar ankuesen se është refuzuar kërkesa lidhur me kompensimin e lartcekur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nga ana e Policisë së Kosovës.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 02.08.2021, nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës, me datën 16.08.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagës së 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor si dhe shtesën në pagë për 0.5% të pagës për çdo vit dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.08.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Me datën 30.08.2021, Policia e Kosovës përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë gjithë dokumentacionin me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje me datë 28.09.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative. Ankuesja ka ndjekur procedurat gjyqësore duke hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 27.01.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2577/2021, i cili në Këshill është pranuar me datën 08.02.2023, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e anuluar njoftimin e datës 28.09.2021 të KPSHMCK-së dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr.735/2021 të datës 16.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 16.08.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.08.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.08.2021 nga ana e Drejtorisë së personelit të Policisë së Kosovës për ankuesen; Kërkesën e ankueses të datës 30.07.2021 drejtuar Drejtorisë së personelit të Policisë së Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të ankueses; Vërtetimin për punësim të datës 29.04.2021 për ankuesen, i lëshuar nga Policia e Kosovës; Diplomën me numër Nr.50 të datës 30.11.2011 të ankueses nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Kopjen e ID-së së ankueses; Kopje e ID-së së ankueses nga vendi i punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.08.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 30.08.2021 nga Policia e Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën zyrtare nga Policia e Kosovës lidhur me dëshminë mbi pagesën e shpërblimit jubilar të ankueses me



numër CIV 1207 te muajit shkurt te vit 2016; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të ankeses të datës 11.09.2015; E-mailin zyrtar të datës 30.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët , ka vërtetuar se ankesa e ankesues Leonora Krasniqi-Gashi , është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankesues lidhur me kompensimin për pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor si dhe shtesën në pagë për 0.5% të pagës për çdo vit dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankesues ka konstatuar se, duke u bazuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankesues në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafit 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që ka qenë në fuqi në këtë kohë, ankesja është nëpunëse civile e punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton kjo dispozitë: *"5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi"*, që në kohën kur është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore që zbatohen për këtë fushë, respektivisht neni 4 paragrafi 1, i këtij ligji, i cili ka përjashtuar vetëm zyrtarët policor nga shërbimi civil në Policinë së Kosovës, mbi këtë bazë për veç tjerash të gjitha pagat e nëpunësve civil dhe shtesat e nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, ishin rregulluar në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, legjislacion që kishte qenë në fuqi në këtë kohë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar nenin 44 paragrafi 2 si dhe duke u ndërlidhur me neni 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës mbi të cilën bazë juridike Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka kompetencë për nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës për personelin policor dhe mbi të cilën bazë juridike ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018 por se që ky udhëzim do të duhej të jetë në harmoni me bazën ligjore që veç është e rregulluar një materie konkrete, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se kishte ekzistuar baza ligjore që kishte rregulluar çështjen e pagave dhe shtesave të ndryshme të nëpunësve civil, siç ishte Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil , rrjedhimisht dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk kanë mund të parashohin të drejta dhe beneficione ndryshe nga si ishte e rregulluar kjo çështje me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, legjislacion që kishte qenë në fuqi në këtë kohë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 kishte aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe i cili është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës më datë 14/06/2010, i cili në dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1,1.2 dhe 1.3 të këtij ligji, kishte përcaktuar se: "1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut", si dhe neni 4 i Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës kishte përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera, mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, nuk kishte marrë për bazë dispozitat e nenit 14,15,16,17 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 4 të Rregullores Nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, sepse në dispozitat të këtij udhëzimi janë përfshirë edhe shtesa dhe beneficione tjera, dhe të cilat në raport me dispozitat e Ligjit për paga Nr.03/L-147 dhe Rregullores Nr.33/2012 që specifikisht rregullojnë këtë fushë nuk mund të kishin fuqi mbizotëruese për nëpunësit civil gjegjësisht stafin civil në Policinë e Kosovës, andaj si i tillë Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës nuk është i zbatueshëm për këtë kategori të nëpunësve civil brenda institucionit të Policisë së Kosovës.

Lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me datë 02.08.2021 Policia e Kosovës, në përgjigjen në ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në të cilën është deklaruar se për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje për buxhet shtesë tek Ministria përgjegjëse, duke parashtruar kërkesë me datë 24.10.2017 tek Ministria e Financave, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve sipas Qarkores me numër Ref.2018/02 për periudhën 2018/2020, dhe e cila kërkesë nuk është aprovuar nga Ministria e Financave.

Në rastin konkret sipas këtij deklarimi zyrtarë të Policisë së Kosovës, është vërtetuar fakti se para se ta miratojë Udhëzimin Administrativ të datës 14.11.2018 Policia e Kosovës ka qenë dashtë të ketë një miratim nga Ministria e Financave konform nenit 47 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës e që në këtë mënyrë përmbajtjen dhe formën e kësaj rregullore e bënë pa bazë ligjore sa i përket kësaj kategorie të nëpunësve civil .

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se, Policia e Kosovës edhe për kundër faktit se nuk është aprovuar kërkesa e datës 24.10.2017 nga Ministria e Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës prapë në kundërshtim me nenin 47 para paragrafin 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 19

paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 23 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili kishte qenë në fuqi në këtë kohë, ku kishte përcaktuar se: *"1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shumën e përgjithshme të shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës", dhe nenin 23 "Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën buxhetore të nevojshme për kompensimin dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës".*

Andaj si përfundim rreth pretendimeve ankimore të ankuesit për kompensimin për pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor si dhe shtesën në pagë për 0.5% të pagës për çdo vit dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Kolegji konstaton se pretendimet janë tërësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit që rregullojnë shërbimin civil në përgjithësi dhe këto çështje që janë objekt i kësaj ankese në veçanti, po ashtu këto kërkesa tashmë janë të vjetruara edhe sikur kjo rregullore të prodhojë efekte juridike ndaj kësaj kategorie të nëpunësve civil nga se si kërkesa janë jashtë afateve ligjore të përcaktuara në dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* e që në rastin konkretë kemi të bëjmë me pretendime ankimore që rrjedhin nga një Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ndërsa ankuesja nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka parashtruar ndonjëherë kërkesë në organin e punësimit, ndërsa kërkesat me pretendimet e paraqitura në këtë ankesë janë jashtë çdo afati ligjor sa i përket kësaj natyre të çështjes.

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi gjegjësisht të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj",* i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj, ndërlikur dhe me dispozitat transitorë të nenit 83 për dispozitat transitorë, të këtij ligji, ku përcakton se: *"1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".*

Kolegji i Këshillit poashtu sa i përket kësaj çështje që është objekt i kësaj ankese, thekson faktin se më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për të punësuarit

në sektorin publikë, duke përfshi edhe kërkesat që janë objekt i kësaj ankese, për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe çdo dispozitë ligjore që kishte rregulluar këtë çështje.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.735/2021, datë 02/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.